



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1463/... Prot.
16

Vlorë më, 21.05.2025

VENDIM

Nr. 59, datë 21.05.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER
SHKENCOR NË "MBROJTJA DHE MENAXHIMI I MJEDISIT DETAR", -
"MARITIME ENVIRONMENT PROTECTION & MANAGEMENT"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, rioorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore ardhur me shkresë Nr 235/1, prot, datë 28.04.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.05.2025,


VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Programit të studimit Master Shkencor në "Mbrotjtja dhe Menaxhimi i mjedisit Detar" - "Maritime Environment Protection & Management".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Shkencave Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore si dhe Zëvendësrektori Akademik në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK


Prof. Dr. AURELA SALIAJ





Prot. Nr. 1280

Aurela Saliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1280 / Prot.
11

Vlorë më, 25 /05/2025

Lënda: Kthim përgjigje

REKTORES SË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
PROF. DR. AURELA SALIAJ


KETU

Sektorit Juridik i është dhënë për zbatim shkresa e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore me Nr.235/1 Prot., dt. 28/04/2025, me lëndë "Disa shpjegime mbi draft rregulloren në programin e studimit MEP&M, për Senatin UV", protokolluar pranë nesh me Nr. 1280 Prot., dt 28/04/2025, në të cilën janë përcjell disa shpjegime mbi draft rregulloren për programin e studimeve "Master i shkencave", "Mbrotja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar". Rishikim i draft rregullore është kërkuar me shkresën Nr.1106/2 Prot., datë 15/04/2025. Në lidhje me këtë shkresë Ju bejmë me dije se:

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 80 Programet e përbashkëta të studimit, në vijim të Marrëveshjes së Përbashkët Konsorciumi për Zbatimin dhe Menaxhimin e Programit të Përbashkët të studimit Master është hartuar draft-rregullorja për programin e studimeve "Master i shkencave", "Mbrotja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar" nga universitetet pjesëmarrëse. Pas kontrollit të ligjshmërisë është kërkuar të rishikohen disa nene si:

1. Neni 3 Baza ligjore, të përcaktohen si bazë ligjore Statuti dhe Rregullorja e Universitetit,

Kërkesa për referim në Statut dhe Rregullore e Universitetit vjen si pasojë e rëndësisë që kanë këto akte në veprimtarinë e universitetit. Statuti dhe Rregullorja janë akte me një rëndësi thelbësore për funksionimin e rregullt dhe efektiv të institucionit. Kërkesa për shtimin si bazë ligjore e Statutit dhe Rregullores është e rëndësishme pasi janë akte të brendshme të nxjerra nga Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë në zbatim vetëm të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Terminologjia "Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjeve të sipërcituara" nuk është e korrekte duke pasur parasysh që në rregullore specifikohet qartësisht mënyra e funksionimit të çdo universiteti pjesëmarrës sipas akteve të secilit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

2. *Neni 9 Stafit akademik dhe procedurat e rekrutimit,*

Në lidhje me këtë nen është kërkuar të përcaktohet numri i stafit akademik i jashtëm që do të angazhohet, dhe jo procedura e rekrutimit të stafit pasi organi i cili do të bëjë rekrutimin e stafit është përcaktuar që do të jetë Bordi Menaxhues i Programit.

3. *Neni 15 Vlerësimi i studentëve,*

Referuar këtij neni është kërkuar të mbahet parasysh përputhshmëria me përcaktimet konkrete në Statutin dhe Rregulloren e UV-së si aktet e brendshme që rregullojnë veprimtarin akademike.

4. *Në nenin 18 Tarifat e shkollimit të studentëve,*

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë me Vendimin Nr. 45, datë 14/11/2022 të Senati Akademik i ka përcaktuar tarifat e studimit në këtë program studimi, duke pasur parasysh lirinë akademike dhe autonominë financiare, referuar këtij përcaktimi paragrafi "*Çdo institucion do të përcaktojë tarifat e programit Master në përputhje me rregulloret e veta dhe rregulloret për të cilat është rënë dakort për programin*", ka nevojë të riformulohet.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËS SEKTORI

Julita SHABANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI


Vlorë më, 28.05.2025

Për zbatim :

- DEKAN FAKULTETIT TË SHËNDETIT
Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli
- DEKAN FAKULTETIT TË EKONOMISË
Prof. Asoc. Zamira Sinaj
- DEKAN FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE
Prof. Dr. Roland Zisi
- DEKAN I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE ✓
Prof. Asoc. Miftar Ramosaçaj

REKTOR

Prof. Dr. Aurela SALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE DETARE

Nr. 235 prot.

Vlore, me 28.04.2025

Lenda: Disa spjegime mbi Draft Rregulloren për programin e Studimit MEP&M, për në Senatin UV

Prof. Asoc. **Miftar RAMOSAÇAJ**
DEKAN FSHTN

Per Rektoren
Prof. Dr. **Aurela SALIAJ**

I nderuar Dekan,
E nderuar Rekore,

Në përgjigje të shkresës së Rektores Nr. 1106/2 prot, datë 15.04.2025 "Mbi disa komente mbi Draft Rregulloren për programin e Studimit MEP&M", pas diskutimit me të tre Koordinatorët e programit të studimit MSc MEP&M dhe bazuar në Marëveshjen e përbashkët të nënshkruar nga tre universitetet që janë pjesë e projektit Erasmus + MEP&M, po ju percjell komentet si në vijim:

1. Neni 3 – Paragrafi i fundit

Keni shtuar frazën:

"Statuti i Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë."

Mendoj se ky paragraf nuk është i nevojshëm, pasi më sipër citohet:

"Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjeve të sipërcituara."

Kjo përfshin edhe statutin, rregulloret e institucioneve dhe të njësisë përkatëse.

Prandaj, specifikimi i posaçëm i Statutit të UoV nuk është i domosdoshëm.

2. Neni 9 – Procedurat e rekrutimit

Ky nen përcakton se është Bordi që vendos kriteret e rekrutimit, ndërsa janë koordinatorët, të caktuar nga departamentet përkatëse, që bëjnë propozimet përkatëse. Bordi i Menaxhimit më pas i miraton ato. Aktualisht, kjo praktikë është e konsoliduar: Bordi ka vendosur kriteret dhe, mbi këtë bazë, është bërë edhe propozimi i stafit akademik.

Ju bashkëngjitet dokumentacioni përkatës Nr.1, datë 12.9.2024, mbi "Kriteret dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Mësimdhënës në MSc MEP&M"

3. Neni 15 – Vlerësimi i studentëve

Vlerësimi i studentëve është përcaktuar në Marrëveshjen tre-palëshe, Neni 7. i njëjtë për të tre Universitetet.

4. Neni 18 – Paragrafi 2

Keni propozuar:

“Tarifat e shkollimit të studentëve në këtë program studimi në Universitetin ‘Ismail Qemali’ Vlorë janë përcaktuar me Vendimin e Senatit Nr. 46, datë 14.11.2022.”

Sërish, mendoj se nuk është e nevojshme të citohet kjo në rregullore, pasi në paragrafin më sipër thuhet:

“Çdo institucion partner do të përcaktojë tarifat për programin Master në përputhje me rregulloret e veta dhe rregulloret për të cilat është rënë dakord për programin.”

Kjo e bën të qartë autonominë e secilit institucion në përcaktimin e tarifave, duke e bërë të tepërt referencën specifike ndaj vendimeve të veçanta.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Drejtues i Njesisë Bazë

Prof. Kristofor LAPA



Programme Management Board
of the Joint Master Program in Maritime Environmental Protection and Management
– MEP&M, adopts document on the

CRITERIA AND RECRUITING PROCEDURES FOR THE TEACHING STAFF

In accordance with Articles 2 and 15 of the „JOINT MASTER CONSORTIUM AGREEMENT FOR THE IMPLEMENTATION AND MANAGEMENT OF THE JOINT MASTER PROGRAM MARITIME ENVIRONMENTAL PROTECTION AND MANAGEMENT“ among the University of Montenegro, "Aleksandër Moisiu" University of Durrës, and "Ismail Qemali" University of Vlorë, stemming from the Erasmus+ MEP&M project, the Programme Management Board hereby defines the following criteria and procedures for recruiting teaching staff.

Article 1

RECRUITING PROCEDURES FOR THE TEACHING STAFF

Selection of Teaching Staff

- 1.1 Each partner institution's Programme Coordinator shall propose academic/scientific and assistant staff for each academic year of the Joint Master Program in MEP&M. The selection shall be based on the criteria outlined in Article 2, as well as the individual's contributions to the implementation of the Erasmus+ MEP&M project. The Programme Management Board shall approve the proposed list by consensus, ensuring, whenever possible, equal representation of all partner institutions.

Engagement of Teaching Staff from other Erasmus+ MEP&M project Institutions

- 1.2 If expertise required for specific topics is unavailable within the partner institutions, the Programme Management Board shall invite academic/scientific staff from the EU universities that participated as partners in the Erasmus+ MEP&M project, namely the University of Cádiz, Spain, the University of Nice, France, and the University of Ljubljana, Slovenia.

Engagement of External Teaching Staff

- 1.3 If expertise required for specific topics is unavailable in Articles 1.1 and 1.2, the Programme Management Board may invite academic/scientific staff from other universities or research institutions.

Institutional Approval and Staff Documentation

- 1.4 The final decision on the selection of academic/scientific and assistant staff shall be submitted as a formal recommendation to the governing bodies of the partner institutions for further processing, in accordance with their internal or national regulations. The recommendation must include the following supporting documentation: Curriculum Vitae (CV), Copy of an official identification document and a Proof of academic/scientific title.

Formalization of Agreements Between Institutions and Staff

- 1.5 Upon final approval at the institutional level, each partner institution shall sign formal agreements with the selected staff members, ensuring their participation in the implementation of the Joint Master Program in MEP&M.

Article 2

CRITERIA FOR SELECTION OF TEACHING STAFF

Qualifications for Academic/Scientific

- 2.1 Academic/scientific staff delivering lectures must hold a Doctor of Science (PhD) degree in a relevant field of expertise.

Qualifications for Assistant Staff

- 2.2 Assistant staff involved in practical and laboratory activities must possess a minimum of an MSc degree in a relevant field of expertise.

Alignment with Course Profiles

- 2.3 Academic/scientific and assistant staff must be aligned with the course profile they will be lecturing.

Language Proficiency

- 2.4 Academic/scientific and assistant staff must be able to lecture or conduct activities in the English language.

MEP&M Programme Coordinator for the UV

Prof. As. Dr. Ermal Xhelilaj



MEP&M Programme Coordinator for UAMD

Prof. Dr. Osman Metalla




Chair of the Management Board of MEP&M

MEP&M programme Coordinator for UoM

Prof. Dr. Danilo Nikolic





Aurela Sali

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTOR

Nr. 1106/2 Prot.

Vlorë, më 15.04. 2025

Lënda: Kthim përgjigje

**FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
PROF.ASOC.MIFTAR RAMOSAÇAJ**

Këtu

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 173/3 prot, datë 07.04.2025, protokolluar pranë nesh me nr. 1106 prot, datë 07.04.2025 "Përcjellje e draft rregullores në programin e studimit MEP&M, për senatin e UV" ju bëj me dije se:

1. Neni 9 "Stafi akademik dhe procedurat e rekrutimit" nuk janë specifikuar, për këtë arsye këkoj **të specifikohen procedurat e punësimit.**


Bashkëlidhur keni shkresën e Sektori Juridik me nr .1106 prot, datë 14.04.2025.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

REKTOR

PROF. DR. Aurela Sali





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1106 Prot.

Vlorë më, 14 /04/2025

RELACION

Në lidhje me draft-rregulloren e programit të studimit "Master i shkencave", "*Mbrojtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar*" të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore


REKTORRES SË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË
PROF.DR. AURELA SALIAJ

Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 80 Programet e përbashkëta të studimit si dhe akteve nënllore në zbatim të tij është hartuar draft-rregullorja për programin e studimeve "Master i shkencave", "*Mbrojtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar*".

Draft-rregullorja ka për qëllim të përcaktoj strukturën, kriteret e pranimit, kohëzgjatjen, organizimin e mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve në programin e studimit Msc MEP&M.

Kjo draft-rregullorja hartohet në vijim të Marrëveshjes së Përbashkët Konsorciumi për Zbatimin dhe Menaxhimin e Programit të Përbashkët të studimit Master për "*Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar*", protokolluar pranë UV-së me Nr. 1745 Prot., datë 22/08/2024.

Në lidhje me marrëveshjen e përbashkët Bordi i Administrimit ka nxjerr Vendimin Nr. 35, datë 31/07/2024 "Për ndarjen e të ardhurave nga tarifat e shkollimit të programit "Master i shkencave" "*Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar*", në të cilin ka miratuar ndarjen e të ardhurave nga tarifa e studimit të këtij programi, i cili do të përdoret për pagesat e personelit akademik të jashtëm si dhe stafit të administratës që do të angazhohen në këtë program studimi. Hapja e programit të studimit "Master i shkencave" "*Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar*" është bërë me Vendim Nr. 46, datë 14/11/2022 të Senatit Akademik "Për miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit "Master i shkencave" "*Maritime environmental protection and management (MEP&M)*", në të cilin janë përcaktuar edhe tarifat e studimit për këtë program si dhe me Vendim Nr.39, datë 21/11/2022 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit "Master i shkencave" "*Maritime environmental protection and management (MEP&M)*"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

Referuar draft-rregullores së përcjell nga Drejtuesi i njësisë bazë të Shkencave Detare, pas kontrollit të ligjshmërisë kërkohet të rishikohen disa nene si:

1. Neni 3 Baza ligjore, të përcaktohen si bazë ligjore Statuti dhe Rregullorja e Universitetit.
2. Neni 9 Stafi akademik dhe procedurat e rekrutimit, të përcaktohet numri i stafit akademik të jashtëm i cili do të angazhohet në mësimdhënie, duke pasur parasysh faktin që stafi i përfshirë si akademik dhe administrativ në këtë program studimi do të paguhet sipas Vendimit Nr. 35, datë 31/07/2024 të Bordit të Administrimit.
3. Në nenin 15 Vlerësimi i studentëve, të mbahet parasysh përputhshmëria me përcaktimet konkrete në Statutin dhe Rregulloren e UV-së.
4. Në nenin 18 Tarifat e shkollimit të studentëve, tarifat e studimit janë përcaktuar me Vendim Senati Akademik Nr. 45, datë 14/11/2022.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËS SEKTORI

Julita SHABANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1106 / Prot.

Vlorë më, 14 /04/2025

RELACION

Në lidhje me draft-rregulloren e programit të studimit "Master i shkencave", "*Mbrojtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar*" të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore


REKTORES SË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË
PROF.DR. AURELA SALIAJ

Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 80 Programet e përbashkëta të studimit si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij është hartuar draft-rregullorja për programin e studimeve "Master i shkencave", "*Mbrojtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar*".

Draft-rregullore ka për qëllim të përcaktoj strukturën, kriteret e pranimit, kohëzgjatjen, organizimin e mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve në programin e studimit Msc MEP&M.

Kjo draft-rregullore hartohet në vijim të Marrëveshjes së Përbashkët Konsorciumi për Zbatimin dhe Menaxhimin e Programit të Përbashkët të studimit Master për "Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar", protokolluar pranë UV-së me Nr. 1745 Prot., datë 22/08/2024.

Në lidhje me marrëveshjen e përbashkët Bordi i Administrimit ka nxjerr Vendimin Nr. 35, datë 31/07/2024 "Për ndarjen e të ardhurave nga tarifat e shkollimit të programit "Master i shkencave" "*Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar*", në të cilin ka miratuar ndarjen e të ardhurave nga tarifa e studimit të këtij programi, i cili do të përdoret për pagesat e personelit akademik të jashtëm si dhe stafit të administratës që do të angazhohen në këtë program studimi. Hapja e programit të studimit "Master i shkencave" "*Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar*" është bërë me Vendim Nr. 46, datë 14/11/2022 të Senatit Akademik "Për miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit "Master i shkencave" "*Maritime environmental protection and management (MEP&M)*", në të cilin janë përcaktuar edhe tarifat e studimit për këtë program si dhe me Vendim Nr.39, datë 21/11/2022 të Bordit të Administrimit *Për miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit "Master i shkencave" "Maritime environmental protection and management (MEP&M)"*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

Referuar draft-rregullores së përcjell nga Drejtuesi i njësisë bazë të Shkencave Detare, pas kontrollit të ligjshmërisë kërkohet të rishikohen disa nene si:

1. Neni 3 Baza ligjore, të përcaktohen si bazë ligjore Statuti dhe Rregullorja e Universitetit.
2. Neni 9 Stafi akademik dhe procedurat e rekrutimit, të përcaktohet numri i stafit akademik të jashtëm i cili do të angazhohet në mësimdhënie, duke pasur parasysh faktin që stafi i përfshirë si akademik dhe administrativ në këtë program studimi do të paguhet sipas Vendimit Nr. 35, datë 31/07/2024 të Bordit të Administrimit.
3. Në nenin 15 Vlerësimi i studentëve, të mbahet parasysh përputhshmëria me përcaktimet konkrete në Statutin dhe Rregulloren e UV-së.
4. Në nenin 18 Tarifat e shkollimit të studentëve, tarifat e studimit janë përcaktuar me Vendim Senati Akademik Nr. 45, datë 14/11/2022.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËS SEKTORI

Julita SHABANI



10.04.25
H. H. H.

per mjetehje
Zv. Rer. R. R. R.
53



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEKANI

Nr. 173/3 Prot.

Vlorë, më 07/04/2025

Lënda: Përcjellje e draft rregullore në programin e studimit MEP&M, për senatin UV

REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
PROF. DR. AURELA SALIAJ

Ju përcjellim draft rregulloren në programin e studimit Master i shkencave "Mbrotjtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar", shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

- Bashkëngjitur gjenden shkresat e Drejtuesit të Njesisë Bazë DSHD

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

DEKANI

Prof. Asoc. Miftar RAMOSAÇAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCËVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I SHKENCËVE DETARE

Nr. 173/2 prot.

Vlore, me 07.08.2025

Lenda: Draft Rregullore per programin e Studimit MEP&M, per ne Senatin UV

Prof. Asoc. **Miftar RAMOSAÇAJ**
DEKAN FSHTN

I nderuar Dekan,

Ne vijim të marëveshjes së përbashkët të nënshkruar nga tre universitetet që janë pjesë e projektit Erasmus + MEP&M, po ju dergoj Draft Rregulloren e programit te studimit MSc MEP&M, per t'u miratuar nga Senati UV.

Kjo Draft Rregullore eshte punuar dhe miratuar nga Bordi i Menaxhimit te Masterit Shkencor MEP&M.

Miratimi i saj ne mbledhjen e DSHD, date 2.4.2025: Draft Rregullore mbi MSc MEP&M e punuar nga te tre niversitetet pjesemarrese ne te UV, UoM, UAMD te miratohet dhe te kalohet ne Senat per miratim te metejshem. Ajo eshte mbeshetur ne Marreveshjen e perbashket trepaleshe 22.08.2024. nr 1754 midis UoM, UAMD, UV e hartuar nga Bordi i Menaxhimit dhe e perkthyer ne gjuhen shqipe.

Menaxhimi i MSc MEP&M behet nga Bordi i Menaxhimit:

Danilo Nikolic UoM
Osman Metalla UAMD
Ernal Xhelilaj UV

Gjeni bashkëlidhur:

1. Rregullore e Programit të Përbashkët të Studimit Master i Shkencave "Mbrotjtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar – MEP&M" – ne gjuhen shqipe
2. Regulation of the joint study program master of science "Maritime Environment Protection and Management – MEP&M" – ne gjuhen angleze
3. Annex 1: Joint Degree Study Plan, Credits and Grades Equivalence (Curriculum)
4. Annex 2: Joint Degree Teaching Plan

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Drejtues i Njesise Baze

Prof. **Kristofor LAPA**

RREGULLORE
E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE
“MBROJTJA DHE MENAXHIMI I MJEDISIT DETAR – MEP&M”

KAPITULLI I

Neni 1

Objekti i Rregullores

- 1.1 Rregullorja (më tej referuar si “rregullorja”) e programit të Masterit të Përbashkët Shkencor në “Mbrotja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar – MEP&M” (më tej referuar si “master”) përcakton rregullat normative për funksionimin e masterit dhe marrëdhëniet ndërmjet universiteteve pjesëmarrëse në këtë program të përbashkët studimi. Rregulloret përcaktojnë misionin e masterit, përvijojnë të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, stafit akademik dhe administrativ, studentëve dhe bashkëpunëtorëve të diplomës master; detajojnë marrëdhëniet e tyre; përcaktojnë rregullat për pranimin e studentëve, mësimdhënien, kërkimin, praktikën, vlerësimin, diplomimin, publikimet dhe rekrutimin e personelit; dhe parashikojnë sanksione në rastet e shkeljeve të rregullores.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

- 2.1 Kjo rregullore synon të mbikëqyrë veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të masterit shkencor në përputhje me objektivat dhe misionin e tij.

Neni 3

Baza ligjore

- 3.1 Baza ligjore e kësaj rregulloreje është:
- Marrëveshja e Konsorciumit për Masterin e Përbashkët për Zbatimin dhe Menaxhimin e Programit të Përbashkët Master “Mbrotja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar”, 9/2024.
 - Ligji Nr. 072/2019 “Për Arsimin e Lartë” në Mal të Zi,
 - Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”
 - Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjeve të sipërcituara.

Neni 4

Subjektet e rregullores

- 4.1 Kjo rregullore zbatohet për organet drejtuese, personelin akademik dhe administrativ, këshillat dhe komisionet, studentët dhe bashkëpunëtorët e diplomës master.

KAPITULLI II

Neni 5

Misioni i programit Master

- 5.1 Ky program studimi synon të edukojë dhe trajnojë specialistë shumë të aftë për sektorët publikë dhe privatë, duke përfshirë autoritetet detare dhe mjedisore, autoritetet portuale, inspektorët e mjedisit, inxhinierët detarë, pronarët e anijeve dhe menaxherët detarë. Këta profesionistë do të jenë vendimtarë në adresimin e sfidave mjedisore detare, promovimin e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit dhe sigurimin e pajtueshmërisë me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 5.2 Për më tepër, programi promovon vlerat etike në shërbimet e mbrojtjes së mjedisit detar në Shqipëri dhe Mal të Zi dhe më gjerë, ndërkohë që ofron një edukim gjithëpërfshirës teorik dhe praktik që përputhet me nevojat në zhvillim të fushës.

Neni 6

Objektivat e programit Master

- 6.1 Objektivat e programit të studimit për Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar, bazuar në misionin e dhënë:
- **Zhvillimi i ekspertizës së specializuar.** Të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi të thelluara në mbrojtjen e mjedisit detar, duke i përgatitur ata për karrierë në sektorët publikë dhe privatë, duke përfshirë autoritetet detare dhe mjedisore, autoritetet portuale dhe industrinë detare.
 - **Rritja e përputhshmërisë rregullatore.** Të trajnojë profesionistë për të siguruar respektimin e rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare mjedisore detare, duke kontribuar në forcimin dhe implementimin efektiv të politikave.
 - **Promovimi i praktikave të qëndrueshme detare.** Nxitja e adoptimit të praktikave të qëndrueshme mjedisore në sektorin detar, duke përfshirë parandalimin e ndotjes, menaxhimin e burimeve dhe ruajtjen ekologjike.
 - **Forcimi i vlerave etike dhe profesionale.** Të rrënjosen parime të forta etike dhe integritet profesional në shërbimet e mbrojtjes së mjedisit detar, veçanërisht në Shqipëri dhe Mal të Zi.

- **Sigurimi i trajnimit teorik dhe praktik.** Të ofrohet një kurrikulë e ekuilibruar që integron njohuritë teorike me përvojën praktike, duke siguruar që të diplomuarit të jenë të përgatitur mirë për të adresuar sfidat mjedisore detare të botës reale.
- **Mbështetja e kërkimit dhe inovacionit.** Të inkurajojë kërkimin dhe inovacionin në mbrojtjen e mjedisit detar, duke u mundësuar të diplomuarve të kontribuojnë në përparimet në menaxhimin e qëndrueshëm detar.

Neni 7

Statusi i programit Master

- 7.1 Programi i Masterit kryhet bashkërisht nga:
- Universiteti i Malit të Zi (UoM), Fakulteti i Studimeve Detare Kotor,
 - Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD), Fakulteti i Studimeve Profesionale, Departamenti i Inxhinierisë dhe Shkencave Detare, dhe
 - Universiteti “Ismael Qemali” Vlorë (UV), Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Departamenti i Shkencave Detare.
- 7.2 Mësimi do të zhvillohet në klasa të pajisura me Sistemin e Menaxhimit të Mësimit në çdo Universitet pjesëmarrës.

Neni 8

Menaxhimi i programit Master

- 8.1 Organet kryesore menaxhuese të programit Master janë:

Organet organizative:

- Bordi Menaxhues i Programit, dhe
- Bordi i Sigurimit të Cilësisë.

Rolet institucionale:

- Koordinator i Programit për secilin institucion partner.
- Koordinator i Sigurimit të Cilësisë për secilin institucion partner.
- Administratori i programit për secilin institucion partner.
- Administratori financiar për secilin institucion partner.

- 8.2 Organi kryesor menaxhues i programit master është **Bordi Menaxhues i Programit (BMP)**. BMP përbëhet nga tre Koordinatorët e Programit të emëruar nga secili institucion pjesëmarrës. Funkcionet kryesore të BMP janë
- Monitorimi i përgjithshëm i implementimit të programit.
 - Përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për rekrutimin e stafit.
 - Miratimi i personelit mësimor për vitin e ardhshëm akademik në bazë të propozimeve të secilit koordinator.
 - Miratimi i kriterëve të regjistrimit të studentit, në përputhje me rregulloret e brendshme të tre institucioneve.
 - Miratimi i kalendarit akademik për vitin e ardhshëm akademik dhe përafrimi i tij sa më shumë me kalendarin akademik të tre institucioneve. Nëse ka dallime midis

ditëve të fillimit të universiteteve në kalendarin akademik, data më e hershme është caktuar të jetë dita e fillimit të mësimi për të tre universitetet partnere.

- Miratimi i kalendarit mësimor dhe përcaktimi i datave të provimeve, datat e prezantimit dhe datat e riprovimeve, në koordinim me profesorët e lëndëve përkatëse dhe përafrimi me rregulloret e brendshme të të tre institucioneve.
- Cakton komisionet e provimit për çdo lëndë të semestrit. Komisioni i provimit përbëhet nga të paktën një anëtar nga çdo institucion partner.
- Propozon ndryshime në kurrikulë për ta përafruar atë me nevojat e tregut

8.3 Bordi i Sigurimit të Cilësisë (BSC). BSC përbëhet nga tre Koordinatorë të Sigurimit të Cilësisë të emëruar nga secili institucion pjesëmarrës. BSC është përgjegjës për cilësinë dhe standardet e përgjithshme të programit Master. BSC i raporton Bordit Menaxhues të Programit.

8.4 Koordinatorët e Programit. Çdo institucion partner do të caktojë një koordinator programi. Koordinatori i programit duhet të caktohet nga stafi mësimor i programit master. Roli kryesor i koordinatorit të programit është monitorimi i zbatimit të përgjithshëm të programit Master, i cili përfshin:

- Administron dosjen e dokumentacionit bazë të programit të studimit:
 - Kurrikulën,
 - Katalogjet e kurseve
 - Korrespondencë me koordinatorë të tjerë të institucioneve partnere të Programit të Përbashkët
 - Kalendarin e mësimdhënies
 - Dokumente të tjera të rëndësishme për programin
- Propozon personelin mësimor që do të angazhohet në mësimdhënie nga institucioni i tij/saj ose personeli i jashtëm mësimor.
- Informon drejtuesin e departamentit ose dekanin e institucionit të tij/saj për vendimet e bordit drejtues.
- Përgatit dhe ngarkon rezultatet e provimeve në e-sistemin përkatës të çdo universiteti.
- Koordinon aktivitetet e programit master.
- Koordinimi ndërmjet institucioneve të tjera të përbashkëta të programit bëhet përmes koordinatorëve të programit.

8.5 Koordinatorët e Sigurimit të Cilësisë. Çdo institucion partner do të caktojë një koordinator për sigurimin e cilësisë. Koordinatori i programit duhet të caktohet nga stafi mësimor i programit master. Funksionet kryesore të koordinatorëve të sigurimit të cilësisë janë:

- Koordinimi i ndërveprimit ndërmjet studentëve, stafit dhe palëve të jashtme të interesuara.
- Monitorimi i procedurave të vlerësimit dhe proceseve të monitorimit të provimeve.
- Sigurimi i zbatimit të politikave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë institucionale.

- Kryerja ose koordinimi i auditimeve të brendshme, raporteve të vetëvlerësimit dhe rishikimeve të cilësisë.
 - Mbledhja dhe analizimi i të dhënave për raporte cilësore (performanca e studentëve, kënaqësia, reagimet e të diplomuarve, etj.).
- 8.6 Çdo institucion partner i programit Master do të caktojë një administrator të programit. Administratori i programit është përgjegjës për:
- Pajtueshmërinë me të gjitha rregulloret administrative,
 - Komunikimin me studentët për të gjitha çështjet administrative.
 - Raportimin te koordinatori i programit.
- 8.7 Çdo institucion partner i programit Master do të emërojë një Administrator Financiar. Administratori Financiar është përgjegjës për të gjitha çështjet financiare dhe siguron pajtueshmërinë me rregulloret financiare. Administratori Financiar i raporton koordinatorit të programit.

KAPITULLI III

Neni 9

Stafi Akademik dhe Procedurat e Rekrutimit

- 9.1 Institucionet partnere do të sigurojnë stafin mësimdhënës për programin Master. Institucionet partnere duhet të sigurojnë që të caktohet staf i mjaftueshëm dhe i kualifikuar siç duhet për të ofruar elementë të ndryshëm të programit Master. Koordinator i Programit i çdo institucioni partner do të propozojë personel akademik/shkencor dhe asistent për çdo vit akademik të programit Master. Përzgjedhja do të bazohet në kriteret e përcaktuara nga Bordi Menaxhues i Programit. Bordi Menaxhues i Programit do të miratojë listën e propozuar me konsensus, duke siguruar, kurdoherë që është e mundur, përfaqësim të barabartë të të gjitha institucioneve partnere.
- 9.2 Nëse ekspertiza e kërkuar për tema specifike nuk është e disponueshme brenda institucioneve partnere, Bordi Menaxhues i Programit do të ftojë staf akademik/shkencor nga universitetet e BE-së që morën pjesë si partnerë në projektin Erasmus+ MEP&M, përkatësisht Universitetin e Kadizit, Spanjë, Universitetin e Nicës, Francë dhe Universitetin e Lubjanës, Slloveni.
- 9.3 Nëse ekspertiza e kërkuar për tema të veçanta nuk është e disponueshme në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Bordi Menaxhues i Programit mund të ftojë personel akademik ose shkencor nga universitete ose institucione të tjera kërkimore.

Neni 10

Miratimi Institucional i Dokumentacionit të Stafit

- 10.1 Vendimi përfundimtar i Bordit Menaxhues të Programit për përzgjedhjen e personelit akademik/shkencor dhe asistent do t'i dorëzohet nga koordinorët e programit si një

rekomandim formal organeve drejtuese të institucioneve partnere (drejtuesit të departamentit ose dekanit të fakultetit) për procedurat e mëtejshme, sipas rregulloreve të tyre të brendshme ose kombëtare. Rekomandimi duhet të përfshijë dokumentacionin mbështetës të mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (CV),
- Një kopje e një dokumenti zyrtar identifikimi,
- Vërtetim i titullit akademik/shkencor.

- 10.2 Pasi të merret miratimi përfundimtar në nivel institucional, çdo institucion partner do të nënshkruajë marrëveshje zyrtare me anëtarët e përzgjedhur të stafit për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e programit Master.

Neni 11

Kriteret e përzgjedhjes së personelit mësimdhënës

- 11.1 Stafi mësimor akademik/shkencor që jep leksione duhet të ketë një diplomë Doktor i Shkencave (PhD) në një fushë përkatëse të ekspertizës.
- 11.2 Stafi asistent i përfshirë në aktivitete praktike dhe laboratorike duhet të ketë të paktën diplomën MSc në fushën përkatëse të ekspertizës.
- 11.3 Academic/scientific teaching and assistant staff fields of expertise must be aligned with the course profile they will be lecturing.
- 11.4 Fushat e ekspertizës të stafit akademik/shkencor mësimdhënës dhe ndihmës duhet të përputhen me profilin e kursit që do të japin mësim.
- 11.5 Stafi mësimor akademik/shkencor dhe asistentët duhet të jenë në gjendje të japin leksione ose të kryejnë aktivitete në anglisht.

KAPITULLI IV

Neni 12

Pranimi i studentëve

- 12.1 Çdo institucion partner do të përcaktojë çdo vit numrin e studentëve që marrin pjesë në programin Master në përputhje me politikat institucionale dhe rregullat kombëtare. Institucionet partnere do të përpiqen të mbajnë një ekuilibër të arsyeshëm në numrin e studentëve.
- 12.2 Çdo institucion kryen pranimet e studentëve në mënyrë të pavarur. Koordinator i programit të çdo institucioni është përgjegjës për këshillimin e studentëve dhe përzgjedhjen e tyre bazuar në kërkesat minimale të mëposhtme:
- Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses programin e studimit Bachelor me një minimum prej 180 ECTS në një nga programet e mëposhtme:
 - Shkencat teknike

- Shkencat e natyrës
- Shkencat sociale
- Shkenca ndërdisiplinore në përputhje me programin e propozuar
- Fusha të tjera përkatëse që lidhen me sektorin e ekonomisë blu, siç është rënë dakord midis të tre institucioneve partnere në bazë vit pas viti
- Studentët duhet të demonstrojnë aftësitë e tyre gjuhësore në anglisht në përputhje me standardet e brendshme të secilit universitet (niveli B-2 ose ekuivalenti).

12.3 Koordinator i programit i çdo institucioni partner do të informojë Bordin Menaxhues të Programit për studentët e përzgjedhur menjëherë pasi të ketë përfunduar procesi i përzgjedhjes.

12.4 Për t'u regjistruar në programin Master, studentët duhet të dorëzojnë dokumentet sipas kërkesave të brendshme të çdo universiteti pjesëmarrës te koordinatori administrativ i programit master ose te personi përgjegjës vendor, sipas rregullave të brendshme të çdo institucioni.

12.5 Kopjet e dokumenteve që çdo institucion partner kërkon për regjistrim paraprak do t'u jepen institucioneve të tjera partnere, sipas kërkesës, në mënyrë që ato të mund të regjistrohen në qendrën e arsimit të lartë për shërbimet universitare.

12.6 Original documents requested by each partner institution will be provided by February of the current year. The original documents remain at the admitted institution and not possible to be removed somewhere else

12.7 Dokumentet origjinale të kërkuara nga çdo institucion partner do të sigurohen brenda muajit Shkurtit të vitit aktual. Dokumentet origjinale mbeten në institucionin e pranuar dhe nuk mund të zhvendosen diku tjetër.

12.8 Informacion dhe dokumente shtesë do të sigurohen nga çdo institucion partner për të përfunduar procesin e pranimi dhe regjistrimit.

Neni 13

Regjistrimi i studentëve, njohja dhe transferimi i krediteve

13.1 Çdo institucion partner do të mbajë të dhënat e duhura të studentëve të regjistruar në Programin Master dhe do t'u sigurojë të gjithë studentëve dhe partnerëve transkriptin zyrtar të të dhënave duke specifikuar aktivitetet që janë kryer.

13.2 Në rastet kur një student ka fituar kredite në studimet e mëparshme master të ngjashme ose ekuivalente me kurset në programin Master, një komision i përbashkët i caktuar nga Bordi Drejtues i Programit do t'i vlerësojë këto kredite për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për njohje. Rezultatet e vlerësimit do t'i komunikohen Bordit Menaxhues të Programit. Në fund, njohja dhe transferimi i krediteve do të bëhet sipas rregulloreve institucionale.

Neni 14

